

VENDIM
Nr.442, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE
PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË
PAVARURA”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 901, datë 19.12.2007, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 3, vlera “11 000 lekë”, zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.

c) Lidhja nr. 2, që përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Shkronja “c” e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c. Paga e pozicionit “Sekretar i titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues” është 53 000 (pesëdhjetë e tre mijë) lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionin “Sekretar i titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues” jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Klasa	Pozicioni	Kategoritë	Paga Mujore	
			Paga individuale	Shtesa e

		1	2	3	4	pozicionit 5
			Paga e grupit (PG)lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	12.000	2%		115.000
II	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme	II-a	12.000	2%		105 000
	Drejtor drejtorie	II-b	12.000	2%		88 000
III	Përgjegjës sektori Inspektor i auditimit të brendshëm.	III-a	12.000	2%		69 000
	Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60 000
	Specialist i nivelit të lartë Inspektor i auditimit të brendshëm	III-b	12.000	2%		52 000
IV	Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	12.000	2%		41 000
	Specialist	IV-b	12.000	2%		31 000

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË INSTITUCIONET E PAVARURA

Institucioni	Pozicioni	Kategoria e pagës
Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive	Inspektor i lartë	II-a
	Ndihmës inspektorë të lartë	II-b
Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit	Përgjegjës i Studios së Monitorimit	III-a
	Monitorues	IV-a
Avokati i Prokurimeve	Inspektor	III-a
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit	III-a
Autoriteti i Konkurrencës	Inspektor i mbikëqyrjes së tregut Inspektor i hetimit	III-a